



Rekomandime për ndarjet buxhetore të vitit 2022

Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar projektbuxhetin për ndarjet buxhetore për vitin 2022. Përmes kësaj letre, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe UN Women ndajnë rekomandimet për Kuvendin e Republikës së Kosovës para se ai të miratojë Ligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2022, kjo në mënyrë që të sigurohet buxhetimi i përgjegjshëm gjinor. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor kërkon që të shpenzohen fonde për të adresuar nevojat potencialisht të ndryshme të grave, burrave, djemve dhe vajzave, të identifikuar përmes analizës gjinore. Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore e bën buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të detyrueshëm për institucionet publike në Kosovë, duke përfshirë këtu komunitet, ministritë, si dhe organizatat e tjera buxhetore. Për më tepër, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#) parasheh që burrat dhe gratë të kenë qasje të barabartë në burimet financiare, natyrore dhe njerëzore të shtetit. Po ashtu, ky program parasheh edhe zbatimin e plotë të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha politikat, sistemet dhe proceset institucionale. Qeveria është zotuar të zbatojë buxhetimin gjinor edhe përmes Rezolutës së Kuvendit të Kosovës të 25 janarit 2018 mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke përfshirë këtu treguesin 5.c.1 për buxhetimin gjinor; Kornizën Suplementare të Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësiwe Financiare ([PEFA](#)) për vlerësimin e menaxhimit të financave publike të përgjegjshme gjinore ([GRPFM](#)); si dhe praktikatat më të mira në menaxhimin e financave publike për shpenzime publike më transparente, më të përgjegjshme, dhe më efektive.

Rekomandimet

- Të kërkohet dhe të rishikohet [Vlerësimi i plotë i Ndikimit Gjinor](#) të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2022, në përputhje me standardet e Kosovës për Vlerësimin e Ndikimit Gjinor, ashtu siç kërkohet nga [Vlerësimet e Ndikimit Rregullativ](#). Të sigurohet se ky vlerësim dhe ligji të identifikojnë dhe të adresojnë në mënyrë të përshtatshme nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, duke kontribuar kështu në barazinë gjinore. Të sigurohet që **analiza gjinore** e shpenzimeve dhe ndarjet buxhetore të adresojnë pabarazitë, duke përfshirë aspektin e ndërthurjes, siç janë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave me aftësi të ndryshme, moshë, përkatësi etnike, si dhe vendndodhje gjeografike të ndryshme.
- Para se të miratohet ky projektligj, të kërkohet ekspertizë gjinore nga Agjencia për Barazi Gjinore, ekspertë gjinorë të pavarur dhe organizata për të drejtat e grave, duke përfshirë këtu RrGK-në, si dhe të ftohen këta akterë në takimet e Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Transfere, dhe në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke ditur se nuk



ka pasur konsultime të mjaftueshme në lidhje me këtë projektligj. Sipas Rregullore për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimeve Publike, Qeveria e ka obligim të konsultohet me OSHC-të brenda një minimumi prej dy javësh.

- Të monitorohet dhe të sigurohet se ka investim në ekonominë e kujdesit, gjë e cila mund të krijojë mijëra vende të reja pune në Kosovë. Krijimi i mundësive të reja për kujdesin ndaj fëmijëve krijon përgjithësisht më shumë mundësi punësimi, u mundëson më shumë grave të punësohen, përmirëson rezultatin mësimor të fëmijëve si dhe kontribuon në të ardhurat e shtetit.
- Përmes të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore, të sigurohet që Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2022 të përfshijnë tregues të performancës buxhetore, që lidhen drejtpërdrejt me përparimin e barazisë gjinore.
- Të sigurohet shpërndarja e fondeve të mjaftueshme për të rritur mundësitë e arsimit parashkollor dhe të kujdesit ndaj fëmijëve, duke përfshirë rregullimin e infrastrukturës si dhe punësimin e mësuesve. Kjo do ta shndërrojë punën e papaguar në të paguar, do t'u mundësojë më shumë grave të punësohen për shkak të qasjes më të lehtë në kujdesin e fëmijëve, si dhe do të rrisë punësimin. Në fakt, studimet e fundit në Evropë dëshmojnë se ekonomia e kujdesit mund të krijojë më shumë vende pune sesa sektori i ndërtimitarisë, si dhe i kontribuon më shumë shtetit duke i kthyer paratë në buxhetin shtetëror. Investimet e tilla do të ishin në përputhje me Objektivat e Barcelonës të BE-së (të cilat Kosovës i duhet ende shumë punë për t'i arritur), me [Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2020](#), si dhe aktivitetet e parapara në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024, për qasje të barabartë në sistemin arsimor parashkollor. Për më shumë rekomandime, shihni raportin e RrGK-së [Kush Kujdeset?](#).
- Të alokohen fonde të mjaftueshme për zbatimin e Konventës së Stambollit, duke përfshirë punësimin e më shumë punonjësve socialë në mënyrë që të trajtohen më mirë rastet e ndjeshme të dhunës dhe viktimat. Po ashtu, të sigurohet që këta punonjës socialë kanë mjetet dhe materialet e nevojshme për të kryer punën e tyre; si dhe të krijohen shërbime emergjente për rastet e dhunës seksuale, të cilat nuk ekzistojnë fare në Kosovë.
- Të alokohen fonde për punësimin e më shumë inspektorëve të punës (gra dhe burra), si dhe për zhvillimin e kapaciteteve të duhura për identifikimin dhe trajtimin e diskriminimit me bazë gjinore në punë, ashtu siç është përcaktuar në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.
- Të sigurohet një linjë e përhershme buxhetore për strehimoret për trajtimin e dhunës me bazë gjinore (përfshirë dhunën seksuale), duke përfshirë burime të mjaftueshme për shërbimet e rehabilitimit dhe riintegrimin në përputhje me zotimet e



Konventës së Stambollit. Të ndahen fondet në kohën e duhur në mënyrë që të gjitha strehimoret të kenë burime të mjaftueshme e të qëndrueshme.

- Të përfshihet një nën kod buxhetor në buxhetin për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për të ndërtuar një qendër për personat me aftësi të kufizuara në Universitetin e Prishtinës, si dhe të bëhet digjitalizimi i literaturës dhe teksteve të shtypura në alfabetin Braille.
- Të sigurohet që shpenzimet e Qeverisë në lidhje me adresimin e pandemisë COVID-19 të bazohen në analiza të mjaftueshme të ndikimit gjinor, për të adresuar nevojat e ndryshme të grave dhe të burrave. Të investohet më shumë në infrastrukturën e duhur sociale, e cila është edhe rekomandim i raportit të RrGK-së "[Pandemia nuk njeh gjini](#)"?

RrGK dhe UN Women mbesin të gatshme për të mbështetur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.